



ODA EKONOMIKE E KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE
NO. 515
26.10.2012
PRISHTINE

50
VJET
SHKURT

Adresa: Nena Tereze, Nr 20, 10000 Prishtinë - KOSOVE
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

KOLEGJI "BIZNESI"

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

Nr. 180/12 Data 24.10/2012
PRISHTINË

NË MES TË

ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS

DHE

KOLEGJI BIZNESI

Me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes Odës Ekonomike të Kosovës dhe Kolegjit të BIZNESIT , me pikësynim përkrahjen e ngritjes së nivelit edukativ dhe profesional të të rinjve kosovar , krijimin e një ambient më të volitshëm ekonomik dhe për të konkurruar në projekte të ndryshme të përbashkëta të përkrahura nga EAR-a,USAID-a , Banka Botërore , Oda Ekonomike e Kosovës dhe Kolegji Biznesi nga Prishtina lidhin këtë memorandum të mirëkuptimit dhe pajtohen të zhvillojnë bashkëpunim në këtë lëmi:

1. Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Kolegji BIZNESI në Prishtinë pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë , përkrahin dhe të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes tyre , në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ , social dhe ekonomik.
2. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Kolegji Biznesi në Prishtinë së bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit ,përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional , ofrimit të shërbimeve përkatëse për këtë subjekt edukativ, gjenerim e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë. Në këtë aspekt Kolegji BIZNESIT në Prishtinë do t'ju ofrojë ndihmë anëtarëve të OEK-së me shërbimet e veta.
3. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Kolegji I BIZNESIT në Prishtinë pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përmirësimin ambientit ekonomik dhe social në Kosovë, hartimin e analizave ekonomike, të paraqesin ofertimin e përbashkët dhe të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve
4. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Kolegji I BIZNESIT në Prishtinë si partner të përbashkët mund të hyjnë veç e veç në raporte kontraktuese me partner të tjerë dhe mund të mbështesin anëtarët dhe klientët e partnerëve si dhe projektet e tyre me qëllim të krijimit të një partneriteti të frytshëm dhe kooperues në mes tyre.

5. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Kolegji I BIZNESIT në Prishtinë, pajtohen që për nevojat e tyre të shkëmbejnë ekspertët dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara ekonomike si dhe studentët e lëmive ekonomike pranë këtij Universiteti të kryejnë praktikën në OEK.
6. OEK dhe Kolegji i BIZNESIT në Prishtinë, do të krijojnë një partneritet për analiza dhe hulumtime shkencore,“ përmes krijimit të një qendre të përbashkët shkencore.
7. OEK dhe Kolegji i BIZNESIT në Prishtinë, si ofrues të përbashkët të këtyre shërbimeve dhe nxitës për një ambient më të mirë ekonomik, pajtohen se do t’ju ofrojnë partneritet institucioneve qeveritare vendore dhe ndërkombëtare në avancimin dhe ngritjen e standardeve drejt integritimit ekonomik të vendit më Bashkimin Evropian.
8. Ky memorandum i Mirëkuptimit dhe i Bashkëpunimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë afat të pakufizuar, përderisa njëra palë me shkrim nuk e njofton palën tjetër 6 muaj më parë, për ndryshimet eventuale.
9. Ky Memorandum i Mirëkuptimit dhe i Bashkëpunimit nënshkruhet në dy kopje për secilën palë nga një kopje.

Prishtinë, 24.10.2012


Mr. Safet Gërxhaliu

Oda Ekonomike e Kosovës



Kolegji i BIZNESIT